

VENDIM
Nr.746, datë 23.6.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE
KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE, QË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN E VEPRAVE
INDUSTRIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat për pjesët e fondit, pyjor dhe kullosor, publik, që hiqen, në përputhje me nenin 34 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe me nenin 17 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, që përdoren për ndërtime të veprave industriale, janë si më poshtë vijon:

a) Çmimi i tokës pyjore, që do të përdoret për truall ndërtimi të jetë 1 (një) euro.

b) Tarifa e heqjes apo përdorimit/shfrytëzimit të pyllit apo të fondit kullosor, kur kontrata e investimit është miratuar me ligj të veçantë, të jetë 1 (një) euro.

2. Procedurat për mënyrën e kryerjes së pagesës, si dhe për lidhjen e kontratës për sipërfaqet e hequra nga fondi pyjor dhe kullosor, që do të përdoren sipas pikës 1 të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

3. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha